



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

**RAPORT VJETOR I AKTIVITETEVE
PËR VITIN 2016**

Mars, 2017

Fjala e Rektorit.....	3
Metodologjia dhe baza ligjore e raportimit.....	5
1. Hyrje	6
2. Orientimet Strategjike të Universiteti të Prishtinës.....	8
3. Raporti i aktiviteteve për 2016.....	11
3.1. Buxheti.....	11
3.2. Personeli (shifrat zhvillimore)	15
3.3. Infrastruktura.....	18
3.4. Profili akademik.....	19
3.5. Programet e studimit	22
3.6. Numri i studentëve	24
3.7. Kërkimet shkencore	27
3.8. Bashkëpunimi ndërkombëtar	28
4. Raporti vjetor i auditorit për shfrytëzimin e duhur të mjeteve	31

Fjala e Rektorit

Kam kënaqësinë e veçantë që në emër të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (tash e tutje UP), të falënderoj studentët si dhe stafin mësimdhënës e administrativ të këtij institucioni për përgjegjësinë e bartjes mbi vete të barrës kryesore të realizimit të edukimit dhe zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi në Kosovë.

Raporti i paraqitur si obligim, që buron nga Statuti UP-së, prezanton aktivitetet e realizuara nga stafi i UP-së gjatë periudhës prill 2016 – dhjetor 2016. Përkundër disa sfidave dhe proceseve operative dhe ekonomike nëpër të cilat UP ka kaluar, raporti në fjalë pasqyron përkushtimin dhe angazhimin e të gjitha organeve të këtij institucioni, për të ofruar studim dhe shërbim sa më cilësor në Republikën e Kosovës.

Zhvillimet e periudhës së raportimit në strukturat më të larta të menaxhmentit brenda UP-së, tregojnë qartazi se përkundër vështirësive që janë hasur në proces, UP ka marrë shumë seriozisht nevojën për ndryshime.

Natyrisht, si rrjedhojë e gjendjes aktuale në UP dhe vet kërkesave të tregut kosovar të punës, UP me përkrahje të MASHT, USAID, Agjencionit Austriak për Zhvillim (ADA), Komisionit Evropian (KE) dhe organizatave tjera vendore e ndërkombëtare që ndihmojnë zhvillimet në UP, janë realizuar aktivitetet të cilat adresojnë nevojat me të cilat përballet sot UP në veçanti dhe shoqëria kosovare në përgjithësi.

Megjithatë, ndryshimet që teknologjia dhe zhvillimet e shpejta të saj, i kanë sjell tregut vendor dhe global përbëjnë një sfidë për UP, e cila përgatit numrin më të madh të të punësuarve aktual dhe të ardhshëm në vend. Kjo është një barrë e madhe për UP dhe kërkon mobilizim dhe organizim të shpejtë në adresim të drejtë.

Raporti adreson aktivitetet dhe sfidat që UP si institucion i arsimit të lartë ballafaqohet në drejtim të realizimit të objektivave të parapara në planin fillestar të punës së menaxhmentit dhe Planit Strategjik Zhvillimor të UP-së 2017-2019, si zhvillimi akademik të jetë më ngushtë i lidhur me arsimin e lartë, tregun e punës, ndërkombëtarizmin dhe nevojat e shoqërisë në tërësi.

Menaxhmenti i UP-së dhe të gjitha organet tjera janë shumë të përkushtuar për të vazhduar punën në përmbushjen e misionit dhe vizionit të UP-së, për të arritur rezultate të krahasueshme në nivel ndërkombëtar si dhe të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Prof. Dr. Marjan Dema, rektor

Metodologjia dhe baza ligjore e raportimit

Ky raport është përgatitur nga ekipi menaxhues i UP-së dhe është paraqitur për aprovim nga ana e Këshillit Drejtues në mbledhjen e datës 30 mars, 2017. Ka pasur vështirësi në përpilimin e tij meqenëse në 5 vitet e fundit nga UP nuk është dorëzuar një raport i ngjashëm dhe nuk ka qenë e mundur të referohen të dhënat në raport me vitin 2015 dhe ka munguar një strukturë e qartë për raportim.

Të dhënat e paraqitura janë mbledhur nga raportet e vetëvlerësimit të njësive akademike, raporti i vetëvlerësimit institucional të Universitetit të Prishtinës, si dhe të dhënat më të fundit, janë siguruar nga njësitë akademike dhe administrata qendrore e UP-së, respektivisht zyrat menaxheriale.

Këshilli Drejtues e ka aprovuar këtë raport në mbledhjen e datës 30 mars, 2017.

I. Hyrje

Objektivat e përgjithshme strategjike të arritura

Misioni

Universiteti i Prishtinës është institucion publik autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimin akademik, kërkimet shkencore, krijimtarinë artistike, këshillimet profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike. UP sipas Statutit ka këto qëllime:

1. Të veprojë si qendër institucionale dhe udhëheqëse për avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës, në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës;
2. Të luajë rolin udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
3. Të ndihmojë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
4. Të synojë të krijojë dhe të mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike;
5. T'i shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efikase;
6. Të bashkëpunojë maksimalisht dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
7. T'u përshtatet standardeve evropiane;
8. Të integrohet plotësisht në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, në Zonën Evropiane të Kërkimeve Shkencore si dhe të ndërmarr hapa adekuat reformues të nevojshëm për arritjen e këtij misioni.

Baza ligjore për raportim

Baza ligjore për hartimin e raportit qëndron në nenin 24 të Statutit të UP-së sipas të cilit Këshilli Drejtues do të publikojë raportin vjetor mbi plotësimin e punës së Universitetit në përputhje me kërkesat e Ministrisë dhe të Agjencisë Kosovare të Akreditimit. Raporti duhet të ofrojë informata lidhur me këto aspekte:

- 1.1. Objektivat e përgjithshme strategjike të arritura;

1.2. Të dhënat statistikore për tërë Universitetin dhe njësitë e tij akademike dhe organizative në lidhje me burimet;

1.2.1. Buxheti (fondet publike dhe private);

1.2.2. Personeli (shifrat zhvillimore);

1.2.3. Infrastruktura;

1.2.4. Profilin akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit etj.);

1.2.5. Programet e studimit;

1.2.6. Numrin e studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit);

1.2.7. Kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet);

1.2.8. Bashkëpunimin ndërkombëtar;

2. Raportin vjetor të auditorit për shfrytëzimin e duhur të mjeteve.

Në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, Këshilli Drejtues i raporton Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për realizimin e planit strategjik zhvillimor më së largu deri më 31 mars të vitit të ardhshëm. Raportet duhet të publikohen në ueb-faqen e Universitetit.

II. Orientimet Strategjike të Universiteti të Prishtinës

Strategjia e fundit e Universitetit 2013 – 2015, ka skaduar para se ky menaxhment të fillojë punën dhe nuk ka përmbajtur caqe të qarta dhe iniciativa strategjike, në bazë të së cilës do të mateshin aktivitetet.

Gjatë vitit 2016, Universiteti ka përgatitur Planin Strategjik (tani e tutje PSUP) 2017 - 2019, aktivitetet e të cilit kanë filluar të zbatohen edhe para aprovimit të tij nga Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 30 dhjetor, 2016.

Plani Strategjik i UP-së 2017 - 2019 është hartuar pas një pune të gjatë të Grupit Punues brenda universitetit por edhe me mbështetjen e projektit Transformational Leadership Program të USAID dhe Qeverisë së Kosovës. Prioritetet e PSUP 2017-2019 janë si në vijim:

1. Rritja e Arsimit, Cilësisë, Universitetit dhe Studimeve

Stimulimin e kuadrit mësimdhënës me kualifikime të doktoraturës për 25% më shumë në 10 vitet e ardhshme. Krijimi i një modeli të ri për arsimin parauniversitar për të përgatitur më mirë studentët e UP-së, për një botë në ndryshim. Zhvillimi dhe zbatimi i një modeli të ri të stafit akademik globalisht konkurrues në mësimdhënie, hulumtim dhe të shërbimeve në UP për të arritur statusin si një institucion që renditet në mesin e 1500 institucioneve më të mira në mbarë botën deri më 2027.

2. Nxitja e Ekselencës Kërkimore.

Të mbështesim misionin tonë kërkimor duke rritur financimin institucional dhe shpenzimet kërkimore me 5 % çdo vit. Të ofrojë investime me shënjestër kërkimin më të avancuar dhe punën krijuese. Krijimi i një qendre dhe menaxhimi për hulumtim, mbështetje kërkimore dhe menaxhim të fondeve nga jashtë (grante).

3. Zhvillimi dhe qëndrueshmëria e programeve dhe gradave.

Duke u bazuar në treg dhe konkurrencë globale kjo do të kërkojë ndjekjen e trendeve në zhvillimin e vendeve të punës dhe nevojave si dhe të një procesi për të matur qëndrueshmërinë e programeve aktuale dhe programet e ardhshme në Universitet.

4. Mbështetja e misionit.

Rritja e stafit të Universitetit për të mbështetur arsimin, kërkimin dhe punën krijuese, shërbimet dhe veprimet. Zhvillimi, zbatimi dhe sigurimi i një përmirësimi të vazhdueshëm në të gjitha shërbimet e UP-së nëpërmjet standardeve ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë dhe akreditimit. Investimi në mjete për sukses. Rritja e investimeve në teknologji të reja, objekte të reja dhe ekzistuese në kampus, si dhe shfrytëzimi i bibliotekës, koleksioneve dhe qasja në to.

5. Të mësuarit për një botë me diversitet

Zbatimi i strategjive të reja për përmirësimin e diversitetit; të nxisë një klimë mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë.

6. T'i shërbejmë Kosovës, komunitetit dhe të diplomuarve.

Zgjerimi i programit në terren për komunitetet në Kosovë; rritja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës dhe mësim në distancë.

7. Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike dhe shërbimeve studentore të fakulteteve të UP-së për të nxitur shkëmbimin maksimal dhe lejimin e kompetencave përtej kufijve.

Këto janë tetë fusha strategjike të identifikuara dhe çdo fushë strategjike është ndarë në iniciativa strategjike me objektiva, detyra-aktivitete, masat, afatet kohore, stafin përgjegjës dhe burimet e nevojshme për të realizuar iniciativën. Listimi i iniciativave strategjike i ofron UP-së fusha me fokus për tri vitet e ardhshme. Lista është një përmbledhje e prioriteteve që duhet të konsiderohen si fusha me fokus institucional, por progresi dhe fokusi duhet të rishikohen duke u bazuar në indikatorë dhe në një proces periodik formal të rishikimit të planit së paku dy herë në

vit. Iniciativat strategjike të listuara janë hartuar me qëllim që secila të jetë e veçantë (të mos përsëriten), por në një plan organizativ kompleks disa nga iniciativat mund edhe të duken si të përsëritura apo të ngjashme.

III. Raporti i aktiviteteve për 2016

Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur të dhënat statistikore raportuese për proceset zhvillimore, por edhe sfidat me të cilat është ballafaquar Universiteti i Prishtinës gjatë vitit 2016.

3.1. Buxheti

Planifikimi i buxhetit për vitin 2016, është bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2016, në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe në Statutin e UP-së.

Burimet prej nga vijnë fondet për buxhetin e UP-së janë me karakter publik dhe vijnë nga: Qeveria, pagesat e studentëve, të hyrat nga puna kërkimore-shkencore dhe donacionet.

Mjetet e Qeverisë sigurohen përmes Ministrisë së Financave, që deri tani janë 84.30% të mjeteve të cilat i ka ndarë për buxhet të Universitetit të Prishtinës. Pagesat e studentëve apo participimi i studentëve është një burim i cili mund të ndahet në: pagesat për semestër, dhe atë të rregullt dhe me korrespondencë, për studentët brenda Kosovës apo jashtë saj, apo sipas niveleve dhe pagesat për shërbimet që paguhen, e të cilat janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ të MASHT, UA/17/2014. Duke u bazuar në ligjet e lartcekura, UP e kishte buxhetin e lejuar për vitin 2016 së bashku me të hyrat e bartura nga viti 2015 si në tabelën 1.

Tabela 1. Buxheti sipas Ligjit të Buxhetit së bashku me të hyrat e bartura

Kategoritë ekonomike	Financimi nga Buxheti	Financimi nga	Totali	Përqindja sipas kategorive
	i Kosovës	të hyrat vetjake		
Paga dhe mëditje	16,790,453.00	4,668,879.79	21,459,332.79	73.60
Mallra dhe shërbime	2,400,286.00	283,318.35	2,683,604.35	9.20
Shpenzime komunale	1,004,793.00		1,004,793.00	3.45
Subvencione dhe transferime	198,782.00	1,101,717.12	1,300,499.12	4.46
Investime kapitale	2,708,462.00		2,708,462.00	9.29
Totali:	23,102,776.00	6,053,915.26	29,156,691.26	100.00

Raport vjetor i aktiviteteve për vitin 2016

Pas miratimit të Ligjit për Buxhetin e vitit 2016, si dhe njoftimit nga Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave mbi ndarjet përfundimtare, menaxhmenti i UP-së e ka bërë ndarjen e buxhetit të aprovuar sipas kërkesave dhe nevojave imediate të njësive akademike, si dhe ndarjen e shpenzimeve fikse në nivel të Universitetit. Ky propozim i menaxhmentit për ndarjen e buxhetit është miratuar nga Këshilli Drejtues i UP-së.

Tabela 2. Buxheti i përgjithshëm i alokuar për vitin 2016 dhe i krahasuar me atë të vitit 2015

Nr.	Përshkrimi	Buxheti Fillestar 2016	Buxheti 2015	Krahasimi në %
1	Paga dhe mëditje	20,896,952.00	22,990,787	90.89
2	Mallra dhe shërbime	2,638,845.00	3,256,233	81.04
3	Shpenzimet komunale	1,004,793.00	868,012	115.76
4	Subvencionet dhe transferet	1,299,000.00	1,314,000	98.86
5	Investimet kapitale	2,708,462.00	3,449,462	78.52
6	Totali	28,548,052.00	31,878,494	89.55

Në periudhën raportuese, totali i mjeteve buxhetore të buxhetuara në vitin 2016 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2015 pati rënie për 10.45 %. UP për vitin 2016 ka pasur të planifikuara të hyrat vetanake në vlerë prej 5,442,276.00 euro, ndërsa ka arritur të realizojë 3,932,498.00 euro apo 72% të vlerës së planifikuar. Kjo vjen si rezultat i UA 17/2014. Në bazë të Ligjit për Buxhetin të vitit 2016, ndarja e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2016 ishte si në vijim:

Tabela 3. Buxheti fillestar dhe përfundimtar duke përfshirë edhe donacionet

Përshkrimi	Ndarja fillestare buxhetore (Ligji i Buxhetit)	Ndryshimi sipas Vendimeve të Qeverisë	Ndryshimet me rishikimin e buxhetit	Ndryshimet për të hyrat vetanake	Ndryshimet për grantet e përcaktuara të donatorëve	Ndarjet finale të buxhetit SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
Paga dhe mëditje	20,896,952.00	174,221.50		563,750.79	251.62	21,635,175.91	0.04
Mallra dhe shërbime	2,638,845.00	(106,999.00)	(50,000.00)	44,759.35	800,156.49	3,326,761.84	0.26
Shpenzime komunale	1,004,793.00	(13,973.00)				990,820.00	(0.01)
Subvencionet dhe transferet	1,299,000.00	(17,700.00)		3,099.12	9,587.54	1,293,986.66	(0.00)
Shpenzime kapitale	2,708,462.00	(357,916.79)	(345,180.00)		34,000.00	2,039,365.21	(0.25)
Gjithsej	28,548,052	(322,367.29)	(395,180.00)	611,609.26	843,995.65	29,286,109	0.03

UP ka shpenzuar buxhetin në masën prej 95.42%. Investimet kapitale gjatë vitit 2016 kanë pasur një performancë jo të mirë të realizimit (75.29%) si pasojë e fillimit të ekzekutimit të buxhetit për investime në vitin 2016 pas datës 01 prill, 2016 me marrjen e mandatit nga menaxhmenti i ri i UP-së, kur edhe është lejuar fillimi i procedurave për ekzekutimin e buxhetit në investime kapitale.

Raport vjetor i aktiviteteve për vitin 2016

Tabela 4. Raporti i ekzekutimit të buxhetit sipas të gjitha burimeve të financimit

Kategoria	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimi	Shpenzimi	Progresi në % i buxhetit final	Progresi në % i buxhetit fillestar
Paga dhe mëditje	20,896,952	21,635,175.90	20,476,039.69	20,475,674.85	94.64	97.98
Mallra dhe shërbime	2,638,845	3,282,825.56	3,227,610.08	2,815,946.80	85.78	106.71
Shpenzime komunale	1,004,793	990,820.48	990,820.48	967,240.65	97.62	96.26
Subvencionet dhe transferet	1,299,000	1,294,186.66	952,896.66	942,213.00	72.80	72.53
Pasuritë jofinanciare	2,708,462	2,039,365.21	2,039,365.21	2,039,222.61	99.99	75.29
Totali	28,548,052	29,242,373.81	27,686,732.12	27,240,297.91	93.15	95.42

Gjatë vitit 2016 janë realizuar këto aktivitete në fushën e buxhetit dhe financave: Shqyrtimi i kërkesave të njësive akademike lidhur me planifikimin e buxhetit të UP-së për vitin 2017. Shqyrtimi i draft buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018 dhe 2019, dërgimi i kërkesës buxhetore në MF. Pagesa e bursave për studentët përfitues për vitin akademik 2015/16 sipas vendimit të KD në shumën totale prej 939,400.00 euro, që do të thotë se 1342 bursistë kanë përfituar nga 700 euro. Kthimi i mjeteve për studentët e liruar nga pagesa e semestrit në shumën prej 567,208.00 euro.

Financimi i Seminarit Ndërkombëtar të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe me shumën prej 24,191.00 euro. Përgatitja e rregullore për themelimin e Bordit Financiar Këshillëdhënës të UP-së, me përkrahjen e organizatës World Learning. Shqyrtimi i Planit të veprimit mbi rekomandimet e dhëna për pasqyrat financiare të vitit 2016. Bazuar në ligj janë unifikuar pagat për stafin administrativ, ku është bashkuar paga bazë dhe pjesa stimulative.

Në vazhden e implementimit të strategjisë së universitetit, është avancuar platforma digjitale në SEMS edhe me katër module shtesë: Menaxhimi i buxhetit dhe financave në UP; Moduli i kontratave akademike; Moduli i menaxhimit të përmbajtjeve (publikimit të materialeve për studentë) dhe Pilot moduli për evidentimin e studentëve në ligjërata dhe ushtrime përmes kartelave me çip.

Shqyrtimi i draft buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018 dhe 2019, dërgimi i kërkesës buxhetore në Ministrinë e Financave.

Angazhimi i Menaxhmentit dhe KD do të jetë që me MF tek pjesa e shtesave të stafit akademik të rritet numri i stafit të rregullt dhe të ulet numri i stafit të angazhuar dhe më orë mbi normë.

3.2. Personeli (shifrat zhvillimore)

Personeli akademik

Në vitin akademik 2016/17, UP ka operuar me gjithsej 924 staf të rregullt dhe 502 staf të angazhuar. Pasqyra e stafit të rregullt dhe të angazhuar sipas njësive akademike paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 5. Numri i mësimdhënësve dhe studentëve sipas njësive akademike në vitin akademik 2016/17

Nr.	Fakulteti	Nr. mësimdhënësve të rregullt	Nr. i mësimdhënësve të angazhuar	Gjithsej mësimdhënës	Nr. i studentëve	Raporti student-mësimdhënës ¹
1	Filozofik	55	43	98	4183	76
2	FSHMN	94	27	121	3379	36
3	Juridik	57	38	95	6955	122
4	FNA	40	36	76	2923	73
5	FIEK	32	41	73	2254	71
6	FIM	42	27	69	1471	35
7	Mjekësi	270	86	356	4244	16
8	FEFS	22	19	41	915	42
9	Bujqësi	43	50	93	1964	46
10	Artet	84	75	159	947	11
11	Edukim	59	16	75	4934	84
12	Ekonomik	63	17	80	10879	173
13	Filologjik	63	27	90	3829	61
14	Gjithsej	924	502	1426	44877	49

Sfidë kryesore për UP mbetet numri i kufizuar i stafit akademik që po kushtëzon mbingarkesën e stafit të brendshëm në mësimdhënie, por edhe nevojën për angazhimin e stafit nga jashtë. Raporti mesatar mes stafit të rregullt akademik dhe studentëve është afërsisht 1:49.

Personeli administrativ

Në vitin 2016, UP ka operuar me 308 staf administrativ prej të cilëve 89 në administratën qendrore dhe 219 nëpër njësitë akademike. Shpërndarja e administratës është paraqitur në tabelën më poshtë:

¹ Ky raport është llogaritur vetëm me stafin në marrëdhënie të rregullt pune në UP.

Tabela 6. Staf i administrativ i UP-së

	Meshkuj	Femra	Total
Fakulteti Filozofik	5	12	17
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	16	14	30
Fakulteti i Filologjisë	7	8	15
Fakulteti Juridik	10	11	21
Fakulteti Ekonomik	6	13	19
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	6	5	11
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	8	8	16
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	5	6	11
Fakulteti i Mjekësisë	5	20	25
Fakulteti i Arteve	4	8	12
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	16	4	20
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sporteve	4	4	8
Fakulteti i Edukimit	5	9	14
Administrata Qendrore- Rektorati + BQU	41	48	89
Totali	138	170	308

Për stafin administrativ, me Vendim të Këshillit Drejtues dhe pëlqimin e Ministrisë së Administratës Publike për herë të parë është arritur të bëhet harmonizimi i pagave bazë me shtesën funksionale në një pagë të vetme.

Sfidë për administratën e UP-së në vitin 2016, ka qenë numri i vogël i saj, pasi që për disa vite të fundit nga MAP nuk është lejuar zëvendësimi as i stafit të pensionuar, e as i atyre që e kanë lëshuar punën.

3.3. Infrastruktura

UP i ka në shfrytëzim 21 objekte.

Tabela 7. Infrastruktura e UP-së dhe raporti për numër të studentëve

Nr.	Objektet / Njësitë Akademike	Hapësira e brendshme /m ²	Nr. i studentëve	m ² / për student
1.	Fakulteti Filozofik	5,038.00	3,438	1.466 m ²
2.	Fakulteti Filologjik	10,905.32	2,900	3.760 m ²
3.	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	5,518.68	3,035	1.818 m ²
4.	Fakulteti Juridik & Fakulteti Ekonomik	11,925.00	14,154	0.84 m ²
5.	Fakulteti Teknik & Arkitekturës	20,495	6,095	3.362 m ²
6.	Fakulteti i Mjekësisë	11,382.00	2,325	4.895 m ²
7.	Fakulteti i Arteve	7,151.00	796	8.983 m ²
8.	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	5,354.00	1,618	3.30 m ²
9.	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit	2,031.00	707	2.87 m ²
10.	Fakulteti i Edukimit	6,316.00	2,928	2.157 m ²
	Total:	86,116.00	37,996	2.266 m²/student
Nr.	Objekti / Administratë	Hapësira e brendshme/m ²	Nr. punëtorëve	
1.	Rektorati	915.00		
2.	Biblioteka Universitare	3,486.00		
Nr.	Hapësirat e jashtme (parkingje dhe hapësira gjelbëruese)	m ²	\	\
1.	Hapësirat e jashtme për të gjitha objektet e UP-së	151,000+8,347.00 =159,347	\	\
Nr.	Njësitë Akademike	Objektet në shfrytëzim	\	\
1.	Fakulteti Filozofik	1.00	\	\
2.	Fakulteti Filologjik	1.00	\	\
3.	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	1.00	\	\

	F.i Kimisë			
4.	Fakulteti Juridik & Fakulteti Ekonomik	1.00	\	\
5.	Fakulteti Teknik	2.00	\	\
6.	Fakulteti i Arkitekturës	1.00	\	\
7.	Fakulteti i Mjekësisë	1.00	\	\
8.	Fakulteti i Arteve	3.00	\	\
9.	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	6.00	\	\
10.	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit	1.00	\	\
11.	Fakulteti i Edukimit	1.00	\	\
12.	Rektorati	1.00	\	\
13.	Biblioteka Universitare	1.00	\	\
	Totali	21.00	\	\

Sfida të shumta e kanë përcjellur infrastrukturën e Universitetit të Prishtinës, si p.sh. problemet rreth ndërtimit të objektit të ri të Fakultetit të Bujqësisë, ndërtimit të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, caktimit të lokacionit për ndërtimin e FSHMN-së, caktimit të lokacionit për ndërtimin e objektit të Fakultetit Ekonomik, dhe përfundimi i punëve në renovimin e kulmit të Bibliotekës Universitare.

3.4. Profili akademik

Nga menaxhmenti i kaluar është trashëguar konkursi për personel akademik i mbetur pezull nga 28 janar, 2015. Me qëllim të trajtimit të lëndëve të mbetura nga ky konkurs është punuar intensivisht në përgatitjen e Rekomandimit 1/344, dt. 22.05.2016 me qëllim të vlerësimit të punimeve të kandidatëve të cilat mund të merren në konsiderim për avancimin e tyre. Pas aprovimit të Rekomandimit në Senatin e UP-së, është formuar një komision këshillëdhënës me ekspert të fushave të ndryshme me qëllim të verifikimit të punimeve të kandidatëve respektivisht verifikimit nëse të njëjtat janë në përputhje me Rekomandimin e Senatit 1/1344. Të gjeturat e ekspertëve të komisionit këshillëdhënës së bashku me raportet vlerësuese të njësive akademike janë shfrytëzuar nga Komisioni i Studimeve për nxjerrjen e propozimit për Senat, në lidhje me

avancimin për secilin kandidat. Propozimet e komisionit të studimeve janë prezantuar para senatorëve dhe të njëjtat janë miratuar pothuajse unanimitisht për secilin kandidat. Si rezultat i procesit të tillë, konkursi i mbetur pezull është përfunduar në fund të korrikut të vitit 2016, pra për një periudhë rreth 4 muaj nga momenti i marrjes së mandatit të menaxhmentit të ri.

Si rezultat i përmbylljes së konkursit në fjalë, një pjesë e konsiderueshme e stafit janë avancuar, rizgjedhë përkatësisht janë rekrutuar për herë të parë. Konkretisht:

Numri i personelit të rizgjedhur (sipas thirrjes akademike):

- a. Asistent 183
- b. Profesor asistent 25
- c. Profesor i asocuar 24

Gjithsejt janë rizgjedhur në thirrjen ekzistuese 232 mësimdhënës.

Numri i personelit të avancuar:

- a. Profesor asistent 35
- b. Profesor i asocuar 27
- c. Profesor i rregullt 29

Gjithsej janë avancuar në thirrje 91 mësimdhënës.

Numri i personelit të zgjedhur për herë të parë:

- a. Asistent 7
- b. Profesor asistent 2

Gjithsej janë zgjedhur për herë të parë 9 mësimdhënës dhe asistent.

Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies

Me qëllim të përmirësimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë ndërmarrë veprime konkrete për funksionalizimin e plotë të Qendrës për Përsosshmëri në Mësimdhënie. Në këtë kontekst është zhvilluar bashkëpunimi i ngushtë me World Learning i cili i ofron përkrahje UP-së në fusha të ndryshme. Si rezultat i këtij bashkëpunimi është organizuar seminari dyjavor në lidhje me Burimet e Ripërtërueshme të Energjisë në Prizren, në bashkëpunim me profesorët e Arizona State University. Përveç kësaj është emëruar Koordinatori i Qendrës dhe për herë të parë që nga ekzistimi i kësaj qendre është bërë ndarja e dy zyrave në objektin e Bibliotekës

Universitare të cilat do të shërbejnë për takimet e trajnerëve dhe për organizimin e trajnimeve me numër të vogël të pjesëmarrësve.

Paralel me punët rreth Qendrës për Përsosshmëri në Mësimdhënie, janë marrë veprime tjera konkrete që ndikojnë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies. Këtu duhet veçuar organizimin dhe koordinimin e projektit ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe shoqatës së Arkitektëve BUMIAD nga Turqia për vizitën studimore dyjavore të 16 studentëve nga Prishtina në Bursë. Qëllimi i këtij projekti respektivisht kësaj vizite studimore ka qenë aftësimi i studentëve për përfitimin e shkathtësive të punës në grupe, punës me ekspert të huaj dhe aplikimit të njohurive teorike në praktikë nëpërmjet disenjimit të një shkolle ekologjike duke u bazuar në traditat arkitektonike të dy vendeve (Turqisë dhe Kosovës). Në projekt kanë qenë të involvuar 16 studentë nga Universiteti i Prishtinës dhe 16 studentë nga Universiteti Uludag i Bursës. Të gjithë studentët kanë qenë të drejtimit teknike. Janë trajtuar dhe aprovuar në Senat programet e reja të studimit:

- Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve - programi Trajner sportiv, niveli Master;
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë - programi Shkencat e ushqimit, niveli Master;
- Fakulteti i Edukimit - programi Edukim inkluziv, niveli Master;
- programi për Pedagog, bashkëpunëtor profesional niveli Master;
- programi për Pedagog për shkolla profesionale niveli Master dhe
- programi për Mësimdhënës lëndor niveli Master;
- Fakulteti i Filologjisë, programi Gjuhë dhe letërsi gjermane niveli Master
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, programi Komunikacion dhe transport, niveli Bachelor
- dhe programi Komunikacion rrugor, niveli Master.

Gjatë këtij viti janë pensionuar 24 pjestarë të stafit akademik, ndërsa asnjë prej tyre nuk është zëvendësuar si rezultat i kufizimeve buxhetore nga MAP dhe shpalljes së konkursit në fund të vitit 2016 e që është në zhvillim e sipër.

Sfidë për profilin akademik mbeten kriteret, gjithnjë në rritje për avancime por edhe për punësime për herë të parë në Universitet dhe përmbushja e kërkesave të Rekomandimit të Senatit për publikimet shkencore. Gjithashtu shpesh në konkurset e hapura mungon stafi i specializuar për profilet e shpallura.

3.5. Programet e studimit

Universiteti i Prishtinës është universiteti më i madh në zonën e arsimit të lartë në Kosovë. Universiteti ka në implementim aktualisht 188 programe në tri nivelet e studimeve ndërsa paraqitja e tyre sipas njësive akademike është si në tabelë.

Tabela 8. Pasqyra e programeve akademike që zhvillohen dhe atyre të reja

Njësia akademike	Programet studimore			Programet e reja 2016		
	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
Fakulteti Filozofik	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	8	7	2	0	0	0
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	9	8	2	0	0	0
Fakulteti i Filologjisë	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	9	7	3	0	0	0
Fakulteti Juridik	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	1	5	5	0	0	0
Fakulteti Ekonomik	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	6	5	4	0	0	0
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	5	7	0	0	0	0
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	8	5	4	0	0	0
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	4	4	0	1	2	0
Fakulteti i Mjekësisë	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	5	2	5	0	0	0
Fakulteti i Arteve	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	9	9	0	0	0	0
Fakulteti i Bujqësisë dhe	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD

Veterinarisë	6	6	0	0	1	0
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sporteve	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	1	1		0	1	0
Fakulteti i Edukimit	BA	MA	PhD	BA	MA	PhD
	4	3	0	0	8	1
Total	75	74	26	1	11	1

Në vitin akademik 2016, janë akredituar pothuajse të gjitha programet e parapara nga njësitë akademike. Rezultat pozitiv ishte sidomos akreditimi i programeve të Fakultetit të Arteve, duke pasur parasysh që në vitin paraprak të gjitha drejtimet e këtij fakulteti janë ballafaquar me vështirësi në procesin e akreditimit si dhe fillimi i programit të Doktoratës në Shkencat e Edukimit në bashkëpunim me Universitetin e Lubjanës.

Vlerësimi i brendshëm përmes pyetësorëve në Sistemin për Menaxhimin e Cilësisë.

Vlerësimi për lëndë dhe mësimdhënës për semestrin veror, filloi në maj dhe zgjati deri në qershor, 2016. Raporti i marrë nga ZZHA për rezultatet nga vlerësimi i brendshëm për vitin 2015/16 ishte si vijon: 15.142 pyetësorë ishte numri total nga studentët (BA dhe MA) të plotësuar në vlerësim, nga numri total i lëndëve aktive për vlerësim 5958 ku u vlerësuan 5774 lëndë.

Në koordinim me ZZHA dhe Zyrën e TI ka filluar vlerësimi i brendshëm. Janë realizuar dhe janë përcjellur kodet ESAC për secilin program të studimit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Është miratuar në Senat Rregullorja për Sigurim të Cilësisë. Është miratuar Rregullorja për Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS).

Është mbajtur takimi i parë i Trupave Këshillëdhënëse të Njësive Akademike. Qëllimi i takimit ishte të shkëmbehen përvojat dhe të diskutohet për rëndësinë e funksionalizimit të Trupave Këshillëdhënëse si një mekanizëm që bënë lidhjen në mes të akademisë dhe tregut të punës për të siguruar cilësi në arsimin e lartë dhe siguruar përgatitjen adekuate të fuqisë.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2016, janë akredituar 81 programe të studimit, ndërsa vetëm 4 programe të studimit nuk janë akredituar për shkak se nuk i kanë plotësuar kushtet formale.

Është krijuar platforma E-Karriera, ku përmes kësaj platforme planifikohet që brenda vitit 2017 shërbimet e ofruara për studentët e UP-së nga Qendra për Zhvillim të Karrierës të digjitalizohen.

Për herë të parë kjo ceremoni është organizuar jashtë objekteve të UP-së dhe ka qenë e hapur për pjesëmarrje për të gjithë studentët e diplomuar të vitit 2016. Në këtë ngjarje kanë diplomuar rreth 500 studentë të UP-së dhe kanë marrë pjesë mbi 1000 familjarë të studentëve, që kanë përcjellur këtë ngjarje nga afër. Gjithashtu, kjo ngjarje synon të shëndrrohet në ngjarje tradicionale të UP-së.

Është përgatitur konkursi për punë praktike për MASHT, për studentët e UP-së. Realizimi i punës praktike të studentëve të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në DOT- Departamentin e Operatorit të Tregut në KOSTT, dhe DP - Divizionin e Qymyrit, Divizionin e Gjenerimit - TC Kosova A dhe TC Kosova B në KEK. Kjo u mundësua nga projekti REPOWER-KOSOVO / USAID

Sfidë kryesore në programet studimore mbeten: numri i kufizuar i stafit akademik sidomos në programet e doktoratës ku problem paraqet mentorimi i kandidatëve në disertacione. Poashtu, ende nuk ka një studim të hollësishëm për tregun e punës për të diplomuarit nga këto programe. UP ka trashëguar borxhe nga vitet e kaluara për proceset e akreditimit të cilat është detyruar t'i paguaj krahas akreditimeve të rregullta vjetore.

3.6. Numri i studentëve

Regjistrimi i studentëve:

Pranimi i studentëve të rinj është realizuar me sukses rigorozisht duke respektuar konkurset e shpallura në afatin e korrikut dhe shtatorit të vitit akademik 2016/17. Konkurrenca ishte e madhe për vend studimi, ku në disa njësi akademike kjo konkurrencë ishte 1:10, gjë që mundësoi edhe përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë. Potencojmë se në dy afatet e regjistrimit numri i konkurrentëve ishte mbi 25.000 ndërsa sipas konkursit janë pranuar mbi 9000 studentë.

UP i kushton kujdes të veçantë edhe regjistrimit të studentëve nga komunitetet në Kosovë, për të cilët me konkurs janë përcaktuar edhe kuotat e veçanta. Poashtu kuota të veçanta me rastin e regjistrimit janë paraparë edhe për studentët e trojeve shqiptare jashtë Kosovës.

Me qëllim të transparencës në të gjitha njësitë akademike janë shqyrtuar të gjitha ankesat e parashtruara nga kandidatët në pranimin e studentëve, që ka rezultuar se rezultatet e pranimit kanë qenë meritore dhe të drejta. Në asnjë njësi akademike në vitin akademik 2016/17, nuk ka pasur numër të regjistrimit të studentëve jashtë konkursit. Shpërndarja e numrit të studentëve sipas njësive akademike në tri nivelet jepet në tabelën më poshtë:

Tabela 9. Shpërndarja e numrit të studentëve sipas njësive akademike

	Total	Të regjistruar 2016/17	Të diplomuar 2016
Fakulteti Filozofik	4183	962	863
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	3379	724	392
Fakulteti i Filologjisë	3829	823	623
Fakulteti Juridik	6955	1312	935
Fakulteti Ekonomik	10879	2161	1399
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	2923	464	218
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	2254	504	173
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	1471	391	123
Fakulteti i Mjekësisë	4244	441	384
Fakulteti i Arteve	947	270	171
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	1964	618	157
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sporteve	915	237	155
Fakulteti i Edukimit	4934	952	669
Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	831		70
Total	49,708	9,859	6,332

Bursat

Përkundër lirimit nga të gjitha pagesat e regjistrimit të studentëve të vitit të parë dhe zvogëlimit të pagesave të studentëve të viteve të tjera Këshilli Drejtues ka realizuar konkursin për bursa për studentët e nivelit bachelor me ç’rast kanë përfituar bursë 1565 studentë në vlerë prej 600 euro dhe në shumë të përgjithshme prej 939.000 euro dhe janë liruar nga pagesa përafërsisht 5000 studentë të 6 kategorive të parapara me Udhëzim Administrativ.

Tabela 10. Numri, shuma financiare e bursave dhe raporti me numrin e studentëve

Nr.	Fakulteti	Nr. i studentëve	%	Shuma në euro	Numri i përgjithshëm i studentëve	Raporti me numrin e studentëve (%)
1	Filozofik	112	7.15	67200	3136	3.5
2	FSHMN	83	5.30	49800	2809	2.9
3	Juridik	212	15.54	127200	5184	4.08
4	FNA	124	7.92	74400	2223	5.57
5	FIEK	59	3.76	35400	1911	3.08
6	FIM	43	2.74	25800	1272	3.38
7	Mjekësi	150	9.58	90000	4011	3.73
8	FSHS	8	0.05	4800	785	1.01
9	Bujqësi	37	2.36	22200	1785	4.87
10	Artet	172	10.99	103200	750	22.93
11	Edukimi	54	3.45	32400	3425	1.57
12	Ekonomik	385	24.60	231000	8689	4.43
13	Filologjik	76	4.85	45600	2782	2.73
14	FSHA-Ferizaj	50	3.19	30000	////	////
	Gjithsej	1565	100	939000	38762	////

Sfidë për studentët ende mbetet numri i madh në disa nga njësitë akademike që po reflekton me komplikime në infrastrukturën mësimore, hapësirën e bibliotekave dhe hapësirën për aktivitete socio-kulturore etj.

3.7. Kërkimet shkencore

Pikësnyimi strategjik i UP-së në raport me kërkimet shkencore është të pozicionohet si universitet kërkimor, lider në mesin e institucioneve të arsimit të lartë në rajon dhe më gjerë.

Në këtë kontekst është disenjuar një sistem vlerësimi për kërkime shkencore në UP. Formalizimi i vlerësimit të rezultateve të një kërkimi shkencor është mbështetur në bazat akademike të të dhënave ku është indeksuar revista shkencore, punimi i publikuar në të dhe autori i parë ose autori korrespondent. Sistemi i tillë është formuluar dhe miratuar si Rekomandim i Senatit (Rekomandimi 1/344, dt. 22.6.16) dhe është zbatuar në mënyrë konsistente në rekrutimin dhe avancimin e stafit akademik të UP-së (pikat përkatëse të Statutit të UP-së për zgjedhje të stafit akademik) dhe në miratimin e punimeve të doktoratës së doktorantëve në UP (pikat përkatëse të Rregullores për studime të doktoratës të UP-së).

Aktualisht, sipas sistemit Webometrics, një rangues ndërkombëtar i universiteteve botërore, UP kryeson renditjen e të gjitha universiteteve shqiptare dhe të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Sipas këtyre të dhënave, UP renditet në vendin e 3790-të.

Në janar të vitit 2016, Webometrics e kishte renditur UP-në në vendin e 3860-të, ndërsa në korrik të vitit 2016 në vendin e 3878-të. Rangimi i fundit i bërë në janar 2017, dëshmon se në vitin e fundit, UP ka shënuar ngritje të konsiderueshme në renditjen e universiteteve botërore. Aspekti i kërkimeve shkencore është komponentë e rëndësishme (emërtohet si “excellence”) në përlllogaritjet e rangimit të sipërpërmendur.

Numri i publikimeve interne të lejuara nga Këshilli Botues i UP-së nga janar 2016, e deri më tani është 17 publikime.

Gjatë vitit të fundit është shënuar rritje e konsiderueshme e numrit të punimeve shkencore nga UP në revista të indeksuara sipas Rekomandimit të Senatit të UP-së nga mësipër. UP është aktualisht në procedurë të kontraktimit të qasjes së plotë të bazës akademike të të dhënave Scopus, me finalizimin e së cilës do të jetë e mundur mbështetja me të dhëna ekzakte e faktit të mësipërm.

Sfidat në fushën e kërkimeve shkencore në UP janë të natyrës materiale: buxheti i pamjaftueshëm i destinuar për kërkime dhe pajisjet e pamjaftueshme laboratorike. Në këtë

kontekst, UP ka themeluar Zyrën Qendrore për kërkime shkencore të sponsorizuara dhe projekte shkencore. UP është duke punuar në inicimin dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet organizatës joprofitabile World Learning të mbështetur nga USAID dhe Zyrës Qendrore për kërkime shkencore të UP-së mbi institucionalizimin në UP të kërkimeve të sponsorizuara, transferit të dijes dhe teknologjisë dhe rregulativës mbi pronën intelektuale.

Janë mbështetur financiarisht të gjitha kërkesat për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare me punime shkencore dhe janë financuar të gjitha kërkesat për publikime të punimeve shkencore në revistat kredibile në shumën deri në 500 euro. Angazhimi do të jetë që të zbatohen dhe avancohen edhe më tutje standardet në punën shkencore të stafit akademik.

3.8. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë vitit 2016, stafi i UP-së për bashkëpunim ndërkombëtar me qëllim të ndërkombëtarizimit si dhe aplikimit të përvojave më të mira të arsimit të lartë të BE-së, ka kryer një sërë aktivitete dhe punësh. Duke pasur parasysh rëndësinë e intensifikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, është vazhduar me aktivitete dhe janë intensifikuar veprimet e karakterit ndërkombëtar siç janë: iniciativa për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit për shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik, pjesëmarrjes intensive në programet Tempus, Erasmus+ dhe programe të tjera si dhe bashkëpunimit me partnerët dhe institucionet e BE-së dhe misionet diplomatike të shteteve të huaja.

Gjatë vitit 2016 janë nënshkruar 33 marrëveshje me institucione të ndryshme vendore, ndërkombëtare dhe rajonale.

Projektet Tempus ku Universiteti i Prishtinës është implementues ose partner implementues janë:

1. Developing and Modernizing Professional Programs in Energy Efficiency in the Western Balkans
2. Modernizing Teacher Education at University of Prishtina" - MEd@UP
3. Development of a new master program in geodesy (MPG)

4. Public health in the Western Balkans – improvement in the field of public health and development of a “one health” educational and scientific architecture in Western Balkans countries "onehealth"
5. Modernizing the 3rd cycle at the University of Prishtina and Developing PhD Program at the Faculty of Economics
6. Sport Professions- Education, Employment, Development in the Balkans Region (SPEED)”
7. Lifelong learning for sustainable agriculture in Alps-Danube-Adria region – LifeSADA

ERASMUS + janë 32 partneritete në kuadër të këtij programi.

Gjatë vitit 2016, janë realizuar 38 mobilitete akademike, prej të cilave outgoing 29 dhe incoming 9 mësimdhënës. Mobiliteti i stafit administrativ është si në vijim: outgoing 14 dhe incoming 5. Mobiliteti i studentëve është në total prej 113, prej të cilëve outgoing 104 dhe incoming 9 studentë. Free mover mobility është si vijon: 2 studentë nga Universiteti Reutlingen dhe Universiteti Siegen i Gjermanisë.

Organizimi i ceremonisë “*Doctor Honoris Causa*” – *Post Mortem* për Nënë Terezën” më 10 dhjetor, 2016.

Janë verifikuar rreth 300 diploma, transkripta të notave si dhe vërtetime të studentëve të Universitetit të Prishtinës. Janë lëshuar mbi 560 konfirmime për lejim të studimeve jashtë vendit. ZMJ ka organizuar Universitetin Veror Ndërkombëtar të Prishtinës nga datat: 4-15 korrik 2016. Gjatë këtij edicioni janë mbajtur 11 kurse të fushave të ndryshme dhe kanë ligjëruar: 11 profesorë ndërkombëtarë, dhe 11 profesorë vendor. Kanë marrë pjesë në këtë edicion: 198 studentë nga Kosova, dhe 108 studentë nga shtetet e rajonit dhe më gjerë si: Austria, Belgjika, Çekia, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Polonia, Suedia, Zvicra, Turqia, Anglia, Shtetet e Bashkuara, Shqipëria dhe Maqedonia. Universiteti Veror është ndihmuar me donacione nga: MASHT, Ministria e Diasporës, Aleanca Kosovare e Bizneseve – AKB, Korporata e Ujit Rugova, Pro-Credit Bank, Kompania Hellenic Kosova “Coca-Cola”.

Sfidat në bashkëpunim ndërkombëtar:

Buxheti minimal dhe shumë i kufizuar

Mungesa e programeve në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera ul numrin e mobiliteteve hyrëse. Mungesë kapacitetesh tek njësitë akademike (të stafit që njeh gjuhë të huaja) me qëllim të shtimit të bashkëpunimit dhe realizimit të projekteve me karakter shkencor. Mungesë interesimi për programet CEEPUS, Visegrad Fund, Mevlana si dhe bursat e universiteteve në vendet e Azisë. Digjitalizimi i pjesërishëm pasi që studentët nuk kanë adresë zyrtare (uni-pr.edu) ku do të mund t'u përcillej informacioni në formë elektronike.

IV. Raporti vjetor i auditorit për shfrytëzimin e duhur të mjeteve

Për vitin kalendarik i cili përfundon më 31 dhjetor 2016, Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) e dorëzon në qershor të vitit 2017, prandaj po paraqesim opinionin e auditimit të ZAP për vitin 2015.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka audituar pasqyrat financiare të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit të ZAP, Pasqyrat Vjetore Financiare të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore. Por, ZAP tërheq vëmendjen në faktin se në regjistrin e pasurive të shpalosur në PVF nuk janë përfshirë të gjitha pronat nën shfrytëzim, për shkak të problemeve të pazgjidhura pronësore. Për më shumë detaje mund të gjendet në ueb-faqen e Auditorit Gjeneral ku është i publikuar “Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor, 2015.